



Pranuar / Dorezuar Prijeto/Prodato Received/Delivry	22.09.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednitica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	5620/2022		119



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.663/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.663/2022 të datës 26.07.2022 të parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit me nr. protokoll: II-773 të datës 28.06.2022 të Nënkryetarit të Komunës së Obiliqit, në çështjen juridike "Masë Disiplinore-Vërejtje", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 22.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa më numër A.nr.663/2022 e datës 26.07.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. SHFUQIZOHET Vendimi me nr. protokoll: II-773 i datës 28.06.2022 i Nënkryetarit të Komunës së Obiliqit.
- III. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Obiliqit që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja, sipas shkresave të lëndës e punësuar në Komunën e Obiliqit, me datë 26.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll: 4312/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me nr. protokoll: II-773 të datës

28.06.2022 të Nënkrjetarit të Komunës së Obiliqit përmes të cilit vendim ankueses i është shqiptuar masë disiplinore, me pretendimet ankimore se Nënkrjetari i Komunës së Obiliqit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik si dhe vërtetimit të gabuar i gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.08.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Obiliqit, ndërsa Këshilli më datë 08.08.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Për shkak të specifikave të lëndës, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 06.09.2022 ka nxjerr Vendim VK.nr.88/2022 me të cilin ka bërë zgjatjen e afatit për vendosjen e ankesës së ankueses për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me numër protokollit 4312/2022 të datës 26.07.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Letërnjoftim i A.A.; Akt Emërim i A.B. i datës 01.06.2015; Autorizim për A.A. me nr. II/381 i datës 21.04.2022; Vendim me numër protokollit II-773 i datës 28.06.2022; Raporti lidhur me procedurat e projekteve e ankueses pa datë; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 01.08.2022; E-mail nga A.M. për C.Z. i datës 08.08.2022 lidhur me përgjigjen në ankesë i protokolluar në Këshill me datë 22.08.2022; Përgjigje në ankesë e datës 08.08.2022; Përshtkrimi i Detyrave të Punës i datës 01.06.2015; Dëshmi lidhur me pranimin e vërejtjes së ankueses A.A. me nr. protokollit 166 i datës 28.06.2022; E-mail nga L.H. për C.Z. i datës 02.09.2022; E-mail nga C.Z. për A.M. i datës 01.09.2022; Vendim i Kryetarit të Komunës së Obiliqit me nr. protokollit II-1548 i datës 31.12.2021; Vendim VK.nr.88/2022 i datës 06.09.2022; E-mail nga A.M. për C.Z. i datës 07.09.2022; E-mail nga B.G. për A.M. i datës 07.09.2022; E-mail nga A.M. për I.M. i datës 07.09.2022; E-mail nga C.Z. për A.M. i datës 07.09.2022; Dëshmi lidhur me udhëtimin zyrtar të Kryetarit të Komunës Obiliqit nga data 26.06.2022 deri me datë 01.07.2022; E-mail zyrtar i datës 22.06.2022; E-mail zyrtar i datës 22.06.2022; E-mail zyrtar i datës 22.06.2022; E-mail zyrtar i datës 22.06.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesja **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga administrimi i provave materiale të lëndës, ka gjetur që ankuesja në bazë të Akt Emërimit të datës 01.06.2015 është e punësuar në pozitën "Zyrtare e Lartë e Prokurimit" në komunën e Obiliqit, ndërsa sipas autorizimit të datës 21.04.2022 të Kryetarit të Komunës e njëjta ushtron detyrat në cilësi të Menaxheres së Prokurimit. Po ashtu, Kolegji i këshillit ka gjetur se Nënkrjetari i Komunës së Obiliqit i ka shqiptuar ankueses vërejtje me shkrim përmes vendimit me numër: II-773 të datës 28.06.2022 pasi që ankuesja ka bërë shkelje të lehta nga paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik me arsyetimin se të njëjtës me datë 24.06.2022 i është kërkuara që të dorëzojë raportin e punës të mbikëqyrësi.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit nga shkresat e administruara të lëndës ka gjetur se Kryetari i Komunës së Obiliqit me datë 31.12.2021 përmes vendimit më numër: II-1548 e ka autorizuar Nënkryetarin e Komunës që të ndihmojë kryetarin e Komunës në ushtrimin e funksionit ekzekutiv, ndërsa sipas pikës 2, të së njëjtit vendim Nënkryetari i Komunës vepron në emër të Kryetarit në mungesë të tij.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses lidhur me ligjshmërinë e shqiptimit të masës disiplinore, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë neni 46 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 si dhe paragrafin 4 nën paragrafin 4.1; 4.2; 4.3 dhe 4.4 ku përcaktohet se: *"Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.2 Shkelje të lehta; Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar"* dhe ka konstatuar se Nënkryetari i Komunës së Obiliqit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankueses ka vepruar në kundërshtim me nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ku përcaktohet se: *"1. Ndaj nëpunësve civil, zbatohen masat e përcaktuara në nenin 47 të Ligjit. 2. Masa disiplinore e përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, nëse nëpunësi ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 të Ligjit"* pasi që nuk ka arritur të përcaktojë apo kualifikojë shkeljen e pretenduar të ankueses siç përcaktohet me nenin 4 paragrafi 4 të së njëjtës rregullore, gjegjësisht i njëjti në vërejtjen e shqiptuar i është referuar në mënyrë të përgjithësuar nenit 46 paragrafit 2 në paragrafit 2.2 të Ligjit nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publikë.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit sipas provave të administruara të lëndës ka gjetur se Kryetari i Komunës së Obiliqit nga data 26.06.2022 deri me datë 01.07.2022 ka qenë jashtë vendi, ndërsa sipas përgjigjes së Menaxheres së Personelit të dhënë me datë 08.08.2022 për Këshillin, me qëllim të sqarimit të vërejtjes së dhënë gjegjësisht masës disiplinore ndaj ankueses, deklaroi se, citoj: *"Nënkryetari i Komunës me datë 24.06.2022 ka kërkuar raport gojor për zyrën e prokurimit. Këshilltari i Kryetarit të Komunës po ashtu deklaroi gojarisht se Nënkryetari i Komunës ka kërkuar që zyra e prokurimit të dorëzojë raportin me datë 24.06.2022 pasi që çdo të premtë mbahet takimi i bordit të drejtorëve "*, andaj mbi këtë bazë Kolegji thekson faktin se duke iu referuar vendimit më numër: II-1548 të datës 31.12.2021 përmes të cilit Nënkryetari i Komunës është autorizuar, gjegjësisht sipas pikës 2 i të njëjtit vendim përcaktohet se Nënkryetari i Komunës vepron në emër të Kryetarit vetëm në mungesë të tij, dhe se i njëjti me datë 24.06.2022 nuk ka mundur dhe nuk do të duhet të vepronte në emër të kryetarit të Komunës së Obiliqit pasi që sipas shkresave të lëndës rezulton se Kryetari ka qenë jashtë vendit nga datat 26.06.2022 deri me datë 01.07.2022 dhe nuk është dëshmuar me asnjë provë se me datë 24.06.2022 i njëjti ka qenë në mungesë, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi me nr. protokoli: II-773 i datës 28.06.2022 i Nënkryetarit të Komunës së Obiliqit është nxjerrë në kundërshtim me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *"1.Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë"*, pasi që Nënkryetari i Komunës së Obiliqit me datë 24.06.2022 nuk ka pasur mandat të udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankueses, rrjedhimisht për të njëjtën ditë, pra për datë 24.06.2022 për veprimet ose mos veprimet e ankueses i njëjti nuk mundet t'i shqiptoj ankueses masës disiplinore.

Po ashtu, institucioni punëdhënës gjegjësisht Komuna e Obiliqit përmes shkresave të bashkangjitura të lëndës të dërguara në Këshill, me asnjë shkresë të lëndës nuk ka mundur të argumentojë nëse ndaj ankueses se është parashtruar kërkesë me shkrim që ankuesja të përgatisë raportin javorë me datë 24.06.2022, andaj Kolegji i Këshillit deklaratat verbale të dhëna nga këshilltari i kryetarit nuk iu ka dhënë rëndësinë e provës material, ngase të njëjtat nuk mundet të provohen në rastin konkret gjegjësisht në këtë procedurë administrative.

Kolegji i Këshillit, meqenëse ka konstatuar shkelje të dispozitave të ligjit material me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankueses, në kuptim të nenit 52 paragraf 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031-për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.5. është në kundërshtim me ligjin material" e ka shfuqizuar Vendimin me nr. protokoli: II-773 të datës 28.06.2022 i nxjerrë nga Nënkryetari i Komunës së Obiliqit si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.663/2022

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Eshref Shabani


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Obiliqit dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.